



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE, LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 692 Prot.

Tiranë, më 11 /11/ 2013

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për parandalimin dhe eleminimin e sjelljeve që cënojnë dinjitetin e individit për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe trajtimin me efektivitet të denoncimeve të bëra nga qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

Drejtuar: **z. Artan DIDI**
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

TIRANË

I nderuar zoti Drejtor i Përgjithshëm!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Institucioni i Komisionerit në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KShH), është duke realizuar ditë të hapura në disa bashki, në kuadër të projektit “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë. Gjatë takimit në qytetin e Lezhës, Komisioneri dhe KShH kanë marrë një numër të lartë ankesash lidhur me sjelljen e punonjësve të policisë ndaj personave që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Më konkretisht, shqetësimet kryesore të paraqituara nga qytetarët kanë patur të bëjnë me abuzime verbale nga ana e punonjësve të policisë ndaj qytetarëve, të cilët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Gjithashtu, në shqetësimet e ngritura nga ana e qytetarëve

ka qënë mungesa e gadishmërisë ndaj denoncimeve apo thirrjeve të bëra nga qytetarët rom dhe egjiptian, ndërsa shprehen se ka një gadishmëri të punonjësve të policisë që të shoqërojnë vetëm individët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian në rastet kur ka një konflikt dypalësh.

Misioni i Policisë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, nuk mund të realizohet në rast se ajo me veprimet apo mosveprimet e saj shkel të drejtat dhe liritë e njeriut, e për më tepër kur sjelljet e punonjësit të policisë ndikohen nga përkatësia e qytetarit në një minoritet të caktuar.

Policia ka përgjegjësi të mbrojë individët nga rreziqe të mundshme, jetën e tyre, si dhe sigurinë dhe pronën e çdo individi, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Ushtrimi i përgjegjësive nga Policia dhe mbrojtja për qytetarët duhet të bëhet në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parime këto që janë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shkelja e parimit të barazisë dhe mbrojtja efektive nga çdo sjellje diskriminuese e policisë është e ndëshkueshme në bazë të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, garant për zbatimin e të cilit është institucioni i Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi.

Masat speciale që policia ka të drejtën të ndërmarrë në ushtrim të përgjegjësive të saj ligjore, si njoftimi për paraqitje në polici, shoqërimi në polici, nuk duhet të përdoren nga ana e punonjëve të policisë si mjet presioni ndaj individit, e aq më tepër pas sjelljeve abuzuese të fshihen motive diskriminuese.

Në çdo rast kur vërehen abuzime verbale ndaj individëve rom dhe egjiptianë, është e domosdoshme që sjellje të tillë të hetohen në mënyrë efektive nga ana e policisë dhe përgjegjësit të marrrin ndërshkimin e duhur. Gjithashtu, përgjegjësit duhet të përgjigjen për çdo rast neglizhencë dhe mungese gadishmërie të treguar ndaj thirrjeve apo denoncimeve të bëra nga individët që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Kërkojmë nga ana Juaj, që në fryshtë e respektimit të ligjit dhe të drejtave e interesave të ligjshme të qytetarëve, bazuar në parimin e barazisë dhe pa u diskriminuar, të vlerësoni në mënyrë maksimale problemin dhe shqetësimet e ngritura nga pjestarët e komunitetit dhe rom dhe atij egjiptian për abuzime verbale dhe mosreagim ndaj denoncimeve të tyre, nga ana e policisë.

Përsa më sipër, nisur nga situata e konstatuar, si dhe bazuar në kompetencat që nenit 32 pika 1/“f” i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i jep institucionit të Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi, por edhe në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit që ekziston midis dy institacioneve tona:



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

REKOMANDOJMË:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të trajnuar punonjësit e policisë për të trajtuar me respekt dhe dinjitet çdo individë pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të marrë masa për të hetuar dhe ndërshkuar çdo rast abuzimi verbal të bërë nga punonjësit e policisë së shtetit ndaj individëve për shkak të përkatësisë së tyre etnike.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të marrë masa për të trajtuar me efektivitet çdo thirrje apo denoncim të ardhur nga çdo individ, pavarësisht nga përkatësia e tij etnike.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të marrë masa që thirrja e personave në polici, shoqërimi i personave në polici, dhe marrja e çdo mase tjeter speciale që parashikohet me ligj për të ruajtur rendin dhe sigurine publike, të bëhet pa diskriminim dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, dinjitetin e individëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj, shprehim gadishmërinë dhe angazhimin e institucionit tonë për të bashkëpunuar në çdo aspekt që do të vlerësoni në nevojshëm, për marrjen e masave të mësipërme.

Kons. K. Kambaros

